



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2015/6 prot.

Tiranë më 2.8.2023

VENDIM

Nr. 33, datë 2.8.2023

PËR KONTROLLUESIN “BASHKIA KAMËZ”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Bashkia Kamëz” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 121, datë 12.07.2023, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit “Bashkia Kamëz”, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga z. _____, në lidhje me përhapjen e paligjshme të të dhënave personale dhe zbatimin e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur një ankesë nga z. _____, nëpërmjet të cilës ankuesi pretendon se, në zbatim të Vendimit nr. 26, datë 12.06.2023 të Komisionerit, Bashkia Kamëz ka vendosur në dispozicion të ankuesit, informacione për subjektet e të dhënave të cilët janë strehuar përkohësisht në banesat kolektive të ndërtuara në kuadër të procesit të rindërtimit, si dhe informacione mbi familjet që preken nga projekti i Parkut të Paskuqanit, në përmbajtje të të cilave ndodhen kategoritë e të

dhënave: “emër, atësi, mbiemër, numër identifikimi, numër celulari, numri i anëtarëve të familjes”. Të dhënat e kryefamiljarëve janë të përfshira në dy tabela, të cilat përmbajnë 27 subjekte të dhënash.

2. Më datë 14.07.2023, grupi i kontrollit u paraqit pranë Kontrolluesit, në zbatim të Urdhrit nr. 121, datë 12.07.2023 të Komisionerit, për kryerjen e hetimit administrativ, si dhe ka kërkuar informacione dhe sqarime në lidhje me rastin. Nga deklaratimet e përfaqësuesve të Kontrolluesit si dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se, me njohjen e Vendimit nr. 26, datë 12.06.2023 të Komisionerit (në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim, “LDI”), përveç informacionit të sanksionuar në pikën 2 të tij, Bashkia Kamëz në cilësinë e Autoritetit Publik, ka vendosur në dispozicion të ankuesit edhe dy shkresa të cilat përmbajnë tabela me të dhëna personale të subjekteve “kryefamiljarë”, që janë strehuar përkohësisht në banesat kolektive të ndërtuara në kuadër të procesit të rindërtimit, si dhe informacione mbi familjet që preken nga projekti i Parkut të Paskuqanit.

Rezulton se, dy shkresat e sipërcituara janë krijuar nga Njësia Administrative Paskuqan dhe i janë komunikuar ankuesit, nga Drejtoria Juridike e Bashkisë Kamëz, nëpërmjet postës zyrtare dhe asaj elektronike dr.juridike@kamza.gov.al, më datë 19.06.2023. Gjithashtu, me shkresën nr. 4914 prot., datë 19.06.2023, Kontrolluesi ka njoftuar edhe Zyrën e Komisionerit, mbi përmbushjen e detyrimeve të Vendimit nr. 26, datë 12.06.2023 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se vendosja në dispozicion të palës kërkuese, të shkresave me të dhëna personale të subjekteve të të dhënave, është realizuar në kundërshtim me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, parashikuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, si dhe në nenin 17 të LDI. Kontrolluesi, duhet të zbatonte detyrimet e sanksionuara në vendimin nr. 26, datë 12.06.2023 të Komisionerit në zbatim të LDI, por dhënia e këtij informacioni nuk duhet të kryej në tejkallim të detyrimit ligjor për informim. Konkretisht, LDI parashikon qartazi në nenin 17, të tij se e drejta e informimit mund të kufizohet nëse dhënia e informacionit dëmton të drejtën për një jetë private.

3. Kontrolluesi ka të instaluar sistemin e video-survejjimit (CCTV), përmes të cilit kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme të godinës (korridoreve). Konstatohet se, Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV) dhe të drejtat që ata gëzojnë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV), është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave, të njihen me të drejtat

që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Në këtë kuadër, Kontrolluesi detyrohet të vendosë në hyrje të ambienteve të survejuara nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV), modelin standard të tabelës informuese të miratuar nga Komisioneri me Udhëzimin nr. 3.

Gjithashtu, Kontrolluesi disponon faqen zyrtare në internet, me domain kamza.gov.al. Konstatohet se në fund të faqes, është vendosur rubrika *“Politika e Privatësisë”*, e cila pasi klikohet, të rikthen sërish në faqen kryesore dhe nuk reflekton asnjë përmbajtje lidhur me informimin e subjekteve të të dhënave. Për rrjedhojë, konstatohet se, subjektet e të dhënave personale nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare, ka detyrimin që të publikojë *“Politikat e Privatësisë”*, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes online të internetit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, dhe konsiderohet mos përmbushje e detyrimit për informim. Në këtë kuadër, publikimi i rubrikës *“Politikat e Privatësisë”* në faqen zyrtare të Kontrolluesit, përmbush më së miri qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në faqe.

4. Kontrolluesi nuk disponon rregullore *“Për mbrojtjen, përpunimit dhe ruajtjen e të dhënave personale”*, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese, duke mos marrë masa konkrete, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”* (në vijim, *“Vendimi nr. 6”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një *“Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit u paraqitën në seancë dëgjimore, ku parashtruan verbalisht argumentet dhe pretendimet si vijon:

Sa i përket objektit të ankesës, i cili konsiston në: *“Dërgimin e dy tabelave me të dhënat personale të subjekteve “kryefamiljarë”, që janë strehuar përkohësisht në banesat kolektive të ndërtuara në kuadër të procesit të rindërtimit, si dhe informacione mbi familjet që preken nga projekti i Parkut të Paskuqanit”, përfaqësuesit e Kontrolluesit argumentojnë se: “Bashkia Kamëz i njej detyrimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar si dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në rastin konkret jemi të vetëdijshëm që ka ndodhur një lapsus nga specialistët që kanë trajtuar praktikën, megjithatë do të merren masa që të mos ndodhin raste të ngjashme në të ardhmen.*

Sa i përket konstatimit në lidhje me mosinformimin e subjekteve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, përfaqësuesit e Kontrolluesit argumentojnë se: *“Tabelat informuese mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV) dhe përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet tij, kanë qenë të vendosura më parë por për shkak të disa restaurimeve të ambienteve ato janë hequr dhe akoma nuk janë zëvendësuar”. Ndërsa sa i përket Politikës së Privatësisë, bëjmë me dije se faqja zyrtare e Bashkisë Kamëz është në zhvillim, dhe akoma nuk është mundur të vendoset informacioni i duhur në këtë menu. Megjithatë do të merren masa sa më shpejtë për plotësimin e “Politikës së Privatësisë” në faqe.”*

Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesve të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e Kontrolluesit për të rikuperuar shkeljet e konstatuara, megjithatë vlen të theksohet se me Rekomandimin nr. 11 datë 06.06.2016 *“Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale nga organet e vet-qeverisjes vendore”, Zyra e Komisionerit ju ka sjellë në vëmendje të gjithë organeve të vet-qeverisjes vendore, detyrimet bazë të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, sikurse janë parashikuar në nenet 5, 6, 18, 21, 22 dhe 27 të ligjit, për rrjedhojë zbatimi i këtyre detyrimeve konsiderohet i njohur.*

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të germave “a”, “b” dhe “dh”, si dhe të pikës 1 të nenit 39, të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 27, 29, 30, 31, 39 (pika 1, germat "a", "b" dhe "dh"), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit;
4. Kontrolluesi të ketë në vëmendje procesin e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me kriteret ligjore të përpunimit, sipas parashikimeve të neneve 5 dhe 6 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të hartojë rregulloren "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave

personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit, etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;

7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimin e përcaktuar në pikën 4 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 5 më sipër;
 - (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 6 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

8. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
9. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
10. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 2.8.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi